



AUSTRI: DREJTORI EKZEKUTIV MERR PJESË NË SAMITIN EUROPIAN TË AVIACIONIT
Gjatë datave 3-4 Tetor në Vjenë u zhvillua takimi i rëndësishëm organizuar nga Komisioni European...

faqe 2



KRISLEN KERI INTERVISTË PËR REVISTËN E "ECAC"
z.Krislen Keri ka dhënë një intervistë për revistën e Konferencës Europiane për Aviacionin Civil...

faqe 3

NËNTOR 2018 - Botimi VII

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



ANALIZË
KEJDA KOSHAJ
ZHVILLIMI I
SEGMENTIT "CHARTER"
NË SHQIPËRI
faqe 4-5

AKTIVITETE
AAC MERR PJESË NË
FORUMIN E SIGURISË
NË ECAC
Në datat 15-16 Tetor 2018 në Paris të Francës, u zhvillua mbledhja e 26 e Forumit të Sigurisë. AAC në këtë aktivitet u përfaqësua nga z. Erion Tema – Drejtor i Drejtorisë së Sigurisë në Aviacion, i cili prezantoi masat...

AVIACIONI NË BOTË
STAMBOLL HAPET
AEROPORTI MË I MADH
NË BOTË
Është hapur zyrtarisht Aeroporti i ri i Stambollit që do të jetë edhe më i madhi në Botë me një ceremoni të veçantë inaugurimi ku morën pjesë politikanë nga gjithë bota. Me një kapacitet priteje prej 100 milionë pasagjerësh në vit...

faqe 10



442 KOMPENSIME

REKORD I KOMPENSIMEVE: KOMPANIA ME NUMRIN MË TË LARTË TË KOMPENSIMEVE "BLUE PANORAMA". NGA TË DHËNAT ZYRTARE PARAPRAKE QË VIJNË PRANË SEKTORIT PËR TË DREJTAT E PASAGJERËVE NGA KOMPANITË AJRORE, REZULTON SE JANË GJITHSEJ 442 KOMPENSIME NË TOTAL ME NGA 250 EURO, OSE ME BILETA FALAS...

faqe 7

AUSTRI: "EUROPEAN AVIATION SUMMIT" DREJTORI EKZEKUTIV MERR PJESË NË PUNIMET E SAMITIT TË RËNDËSISHËM TË AVIACIONIT

Drejtori Ekzekutiv i AAC-së Krislen Keri mori pjesë në Samitin European të Aviacionit me temë "Up to the Next Level", që u zhvillua gjatë datave 3-4 Tetor në Vjenë, Austri. Takimi i rëndësishëm organizuar nga Presidenca Austriake e BE-s dhe Komisioni European, shërbeu për të ritheksuar rëndësinë e aviacionit në përditësimin mbi sfidat në sektor. Në këtë takim u rikonfirmua se aviacioni zhvillon ekonominë, krijon vende pune, facilton tregtinë dhe lejon njerëzit të udhëtojnë në çdo destinacion. Europa duhet të qëndroj një konkurrence e fortë dhe të përfitojë nga të gjitha mundësitë që një ekonomi tejet e zhvilluar ofron. Gjithashtu në këtë takim u diskutua progresi i arritur dhe masat që duhet të ndërmerren në kuadër të "Strategjisë së Aviacionit për Europën" miratuar nga Komisioni European në Dhjetor të 2015, ku ndër sfidat kryesore mbeten vonesat e fluturimeve për shkak të kapaciteve të navigimit, etj. Në këtë Samit u organizuan panele të ndryshme, diskutime të cilat u fokusuan rreth aviacionit civil ndërkombëtar, dixhitalizimit etj. Pjesëmarrje të rëndësishme pati dhe nga niveli i lartë përfshirë Komisionerja e BE-s për transportin Violeta Bulc, Ministrat European të Transportit, Anëtar të



Në foto:
gjatë Samitit European të Aviacionit "Up to the Next Level"

Parlamentit European si dhe Drejtues të Autoriteteve të Aviacionit Civil në Europë.



Në foto:
pjesëmarrësit gjatë Samitit European të Aviacionit "Up to the Next Level"

INTERVISTË PËR REVISTËN E ECAC

Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil z. Krislen Keri ka dhënë një intervistë për revistën e Konferencës Europiane për Aviacionin Civil (ECAC), ku foli për objektivat që institucioni ka, që lidhen me rritjen e kapaciteteve njerëzore për të përballuar sfidat e të ardhmes, si hapja e 2 aeroporteve të reja në jug dhe në veri të vendit. Gjatë këtij viti AAC ka bërë një lloj të ri bashkëpunimi me "JAA TO", për të marrë trajnime brenda vendit në fusha të caktuara.

Intervista e plotë:

Z. Keri cilat janë objektivat dhe prioritetet që Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar ka në vitet që vijnë?

Sektori i aviacionit civil shqiptar është duke kaluar një fazë intensive zhvillimesh, kjo e lidhur ngushtë me objektivat e Qeverisë për të hapur dy aeroporte të reja një në Jug të vendit dhe një në Veri. Këto zhvillime vijnë në një moment të rëndësishëm pasi aviacioni civil po regjistron rritje të madhe të numrit të pasagjerëve dhe padyshim lind nevoja për të diversifikuar shërbimet aeroportuale. Është e rëndësishme që për një industri të fortë duhet dhe një ent rregullator në lartësinë e duhur, për këtë ne jemi duke punuar fort që të arrijmë përshtatjen e rregulloreve kombëtare me "acquis communautaire", në mënyrë që të arrijnë standartet europiane në rregulloret për aviacionin.

Si kanë qenë këto kurse deri më tani?

Opinionet pas kurseve nga ekspertët tanë, kanë qenë shumë të mira. Disa prej tyre kanë marrë njohuri të reja për funksionet që kryejnë, ndërsa disa të tjerë po shtojnë njohuritë në fushat specifike, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare.

Sa e kanë ndihmuar trajnimet e ofruara nga JAA TO-s për të arritur këto objektiva?

Ne besojmë se një kontribues i madh në pasjen e një enti rregullator të fortë është një staf i trajnuar dhe i kualifikuar. Për të arritur këtë objektiv, AAC ka kërkuar ndihmën e JAATO-s për të forcuar kapacitetet njerëzore. ICAO-TNA (analiza e nevojave të trajnimit) ishte pjesë e këtij procesi. Nëpërmjet këtij ushtrimi, arritëm të kemi një panoramë të qartë të nevojave për trajnime teknike dhe nevojave të tjera që stafi jonë kishte, dhe më pas kaluam edhe te faza tjetër, që lidhet me fillimet e trajnimeve. Tani jemi në fazën që po organizojmë 5 trajnime brenda vendit duke trajnuar 50 punonjës, duke krijuar hapësirën që brenda 6 muajve, të arrijmë një nivel shumë të lartë në fushën e aviacionit.



Në foto:

z. Krislen Keri, Drejtor Ekzekutiv i AAC

Cili do të jetë hapi i radhës?

Bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare trajnimet nuk janë ezauruese për të marrë dijen dhe njohuritë e nevojshme, për ti aplikuar në punën e përditshme. Disa hapa të nevojshëm janë trajnimet në vendin e punës dhe mënyra e praktika e të bërit të gjërave nga ekspertët më të mirë dhe të kualifikuar ndërkombëtar. Fatmirësisht në këtë aspekt kemi bashkëpunuar me palën italiane ENAC, nëpërmjet një memorandum të bashkëpunimit të firmosur pak kohë më parë, dhe besojmë do të marrim përfitojmë shumë nga ky bashkëpunim. Më këtë rast dua të falënderoj edhe homologun tim Italian Alessio Quaranta për angazhimin e tij.



News from the JAA Training Organisation (JAA TO)

► Albanian CAA receives in-house training courses from JAA TO

Paula V. de Almeida, JAA TO Director

July and August were very active months for staff at the Albanian Civil Aviation Authority (CAA). After the Training Needs Analysis (TNA) – a new programme provided by JAA TO – the CAA and ECAE have started to implement the training courses requested by JAA TO for a few training courses, considered to be relevant to the Albanian CAA inspectors. Some courses have already taken place. We interviewed the CAA Executive Director, Krislen Keri, and talked to others in the CAA to find out how the training is going so far.



► Interview with Krislen Keri, Executive Director of the Albanian Civil Aviation Authority (CAA)

1. Mr Keri, what are the CAA of Albania's goals and priorities for the coming years?

Mr Keri: The Albanian civil aviation sector is undergoing some major developments as the Albanian government seeks to develop two additional airports, one in the north of the country and one in the south. These airports come at a time when the Albanian air transport market has witnessed a considerable increase in traffic numbers, and the aim is to offer airport services diversification. However, a strong industry needs a strong regulator and we are working hard to achieve full compliance of national regulations with the acquis communautaire, in order to achieve European standards in aviation regulation.

2. How has JAA TO helped CAA Albania in the achievement of such goals? Did the Training Needs Analysis (TNA) help?

Mr Keri: We believe that a major contribution to a strong regulator is an adequately qualified staff. For this, the Albanian CAA has partnered with JAA TO to tackle staff competence needs. The JAA TO tool was part of this process. Through this joint exercise, we managed to do a full gap analysis of our staff's needs and technical competencies and then moved on to a tailor-made training solution. We are in the process of organizing in-house training courses for 50 people, and all of this within six months, giving us a chance to reach the latest developments in the field.



3. How has the course been so far?

Mr Keri: The feedback from our inspectors is great. Some of them have gained new knowledge of their functions and others are updating their knowledge in specific fields, according to best international practices.


4. What is the next step?

Mr Keri: According to best international practices, training is not all that is needed to gain the appropriate competence to exercise our duties. Other components are on-the-job training (OJT) and the transfer of best experiences from qualified European inspectors. Thankfully, in this regard we have already collaborated with the Italian CAA (ENAC) via Memorandum of Understanding signed between our two organizations. We are especially thankful to ENAC Director General, Alessio Quaranta, for this joint undertaking, which will help us accomplish the next steps.

Në foto:

Intervista e z. Keri e botuar në revistën e Konferencës Europiane për Aviacionin Civil (ECAC)

ZHVILLIMI I SEGMENTIT “CHARTER” NË SHQIPËRI



Kejda Koshaj
Sektori i Planifikimit
Strategjik në AAC

Përgjatë 10 viteve të fundit fusha e aviacionit dhe në veçanti sektori i fluturimeve charter ka pasur një zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri. Linjat charter janë fluturime jo të rregullta, direkte, me qëllime tregtare mes dy destinacioneve. Analiza si më poshtë do ti kushtohet pikërisht këtyre fluturimeve dhe mënyrës se si kanë evoluar në tregun tonë. Statistikat e prezantuara nga specialistët e Autoritetit të Aviacionit Civil, tregojnë për një fluks në rritje të pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet transportit ajror me fluturime charter ndër vite. Fenomen ky që bëhet akoma më i dukshëm kur lejet e dhëna nga AAC, bazohen më së shumti në kërkesat e kompanive të huaja që duan të fluturojnë drejt Shqipërisë. Një nga arsyt kryesore padyshim është edhe rritja e investimeve nga ana e shtetit shqiptar, në infrastrukturë dhe në plotësimin e shumë standardeve të kërkuara, por gjithashtu dhe nga ana e biznesit privat, duke ofruar kushte më të mira për turistët e huaj, e duke e kthyer vendin tonë në një nga destinacionet më tërheqëse. Nëse do të krahasonim numrin e pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja charter në

vitin 2013, me atë të vitit 2018, shifrat na tregojnë një numër shumë herë më të lartë gjatë vitit të fundit. Më konkretisht, përgjatë vitit 2013 numri i pasagjerëve që udhëtonin me charter ka qenë 27,000, ku më së shumti konsistonte në shtetas shqiptarë të cilët kanë udhëtuar drejt Turqisë gjatë sezonit turistik për pushimet verore, ndërkohë që viti 2018 paraqitet krejt ndryshe. 265,000 pasagjerë kanë zgjedhur të udhëtojnë me fluturime charter për/nga Shqipëria deri në fund të muajit gusht. Duhet theksuar se tashmë ky numër konsiston më së shumti në turistë të huaj që kalojnë pushimet në Shqipëri, vetëm përgjatë këtij viti, listës së destinacioneve me fluturime charter nga e gjithë bota, i janë shtuar gjashtë destinacione të reja, si: Kopenhagen (Danimarkë), Goteborg dhe Stokholm (Suedi), Gdansk dhe Katowicë (Poloni), Oslo (Norvegji) si dhe katër kompani të reja Charter, secila me nga dy fluturime në javë si:

1. Braathers Regional Aviation
2. Scandinavian Airlines
3. Jet Time
4. Israair

Tre vitet e fundit kanë qenë një progres i vazhdueshëm në këtë sektor, sikurse pasqyrohet dhe në tabelën më poshtë. Duhet theksuar fakti se vetëm përgjatë tre mujorit të tretë, të vitit 2018 janë numëruar 1758 ulje/ngritje për fluturimet charter, si dhe 2878 prej fillimit të vitit 2018.

	Charter	2016	2017	2018	% e ndryshimit 2017-2016	% e ndryshimit 2018-2017
1	Maj	5,725	3,171	9,669	-44.61%	204.92%
2	Qershor	16,845	21,361	44,392	26.81%	107.82%
3	Korrik	33,628	47,835	79,311	42.25%	65.80%
4	Gusht	46,092	57,522	80,543	24.80%	40.02%

Tabela 1 :
Informacion krahasimor i tre viteve të fundit mbi numrin e pasagjerëve për fluturimet “Charter” gjatë periudhës Maj-Gusht.



ZHVILLIMI I SEGMENTIT “CHARTER” NË SHQIPËRI

Siç dhe pasqyrohet në tabelë, viti 2018 ka arritur kulmin e numrit të pasagjerëve në TIA. Muajt e parë të vitit tregojnë shifra jo shumë të larta duke i krahasuar me dy vitet parardhëse, por shifrat ndryshojnë me kalimin e muajve, për të kulmuar në muajt Korrik-Gusht ku kurba shënon edhe një rritje mbresëlënëse. Rritja është e dukshme në fillimin e muajit Maj, me një numër prej 9669 pasagjerë ose 205% më e lartë se një vit më parë. Për të vijuar me Qershorin, ku numri i pasagjerëve është 44,392 ose 108% më i lartë se në vitin 2017, si dhe Korriku me 79,311 pasagjerë ose 66% më lartë se e njëjta periudhë e vitit 2017 dhe për të kulmuar me Gushtin, i cili regjistron edhe numrin më të lartë të pasagjerëve të cilët kanë udhëtuar me fluturime charter, më saktësisht 80,543 pasagjerë, shifër kjo 40% më e lartë se numri i pasagjerëve për Gushtin e 2017. Numri i pasagjerëve për muajin Gusht 2018 është një tregues tepër domethënës në rritje pasi përbën 21% të totalit të të gjithë pasagjerëve që kanë udhëtuar për/nga Aeroporti “Nënë Tereza” me të gjitha Kompanitë Ajrore. Megjithatë duhet nënvizuar fakti se shifra më e lartë e mbizotërimit të tregut nga kompanitë charter ndaj totalit të

pasagjerëve përgjatë muajve, është arritur në muajin Korrik 2018, me 23%, shifër kjo rekord për sa i përket përqindjeve të fluturimeve charter ndaj numrit total të fluturimeve. Është shumë inkurajues fakti se përgjatë vitit 2018 në Aeroportin “Nënë Tereza” një përqindje të lartë ka zënë dhe numri i turistëve italianë, të cilët kanë mundësi të udhëtojnë drejt Shqipërisë me fluturime të programuara nga kompanitë: Alitalia, Blue Panorama, Ernest S.p.A, Albawings, të cilat operojnë nga më shumë se dhjetë destinacione të ndryshme për/nga vendi fqinj, sidomos përgjatë periudhës së verës, ku numri i fluturimeve të programuara nga këto kompani është tepër i lartë. Natyrisht tashmë mendohet se kurba e shifrave do të njohë rritje të mëtejshme pasi parashikimet janë edhe më optimiste me ndërtimin e Aeroportit të Vlorës dhe gjithashtu vendosjen në përdorim të Aeroportit të Kukësit, ku ndikimi do të jetë direkt në rritjen e numrit të turistëve dhe rritjes së interesit, si për turizmin malor ashtu edhe për atë bregdetar në vendin tonë.



PARIS: AAC MERR PJESË NË FORUMIN E SIGURISË NË ECAC

Në datat 15-16 Tetor 2018 në Paris të Francës, u zhvillua mbledhja e 26 e Forumit të Sigurisë. AAC në këtë aktivitet u përfaqësua nga z. Erion Tema – Drejtor i Drejtorisë së Sigurisë në Aviacion, i cili prezantoi masat e marra nga pala shqiptare për sigurinë në aviacion. Forumi nxori 4 konkluzione si prioritet: Kontrollet e pastërtisë, duke parë nevojën për të përmirësuar kontrollet e pastërtisë dhe për të ndihmuar në adresimin e kërcënimeve të brendshme, Forumi vuri në dukje ndikimet e mundshme në rekrutimin e stafit, veçanërisht në vështirësitë në marrjen e informacionit të mjaftueshëm nga shtetet e tjera. Mekanizmat më të mirë të nevojshëm për shkëmbimin efikas të dhënave. Harmonizim më të madh të kriterëve s'kualifikuese 2. Siguria dhe rritja. Në diskutimin e ndikimeve të mundshme të rritjes së qëndrueshme në trafikun ajror për sigurinë e aviacionit. Forumi vuri në dukje spektrin e gjerë të sfidave që paraqiten, në aspektin e infrastrukturës, çështjeve të personelit, përvojës së udhëtarëve dhe madje sjelljes së pasagjerëve (të padisiplinuar). Këto sfida u përkeqësuan nga rritja e kërcënimeve dhe nga përhapja e masave shtesë në përgjigje të kësaj. Rritja e rrjeteve të operatoreve ajrore gjithashtu theksoi nevojën për një shkëmbim më të gjerë të informacionit të kërcënimit, midis autoriteteve dhe operatoreve. Megjithatë, rritja sjell gjithashtu mundësi, sidomos burimet dhe momentin për të zhvilluar qasje inovative për sigurinë e aviacionit, qoftë përmes teknologjisë së re, rregullimit më të mirë, apo ndryshimeve në kulturën e sigurisë, duke përfshirë zhvillimin e Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë. Prioritetet për vitin e ardhshëm. Në paraqitjen e prioriteteve të tyre për vitin e ardhshëm,



Në foto:

z. Erion Tema - Drejtor i Drejtorisë së Sigurisë në Aviacion në AAC, gjatë mbledhjes së Forumit.

shumica e pjesëmarrësve përmendën sigurinë në terren, kontrollet më të forta, dronët, sigurinë kibernetike, qentë zbulues të eksplozivëve, kulturën e sigurisë dhe teknologjinë. Forumi mirëpriti një propozim të paraqitur nga Irlanda për ngritjen e Programit të Shkëmbimit të Inspektorëve Kombëtar dhe shtetet Anëtare u inkurajuan që t'i përgjigjen pozitivisht ftesës së ardhshme për të marrë pjesë.



RAPORTI I PERFORMANCËS

MUAJI TETOR

Raporti i performancës për muajin Tetor, tregon se ka një ulje të numrit të fluturimeve të vonuara apo anulimeve, kjo për shkak të uljes edhe të fluksit të fluturimeve. Nga të dhënat që vijnë për këtë muaj, rezulton se kompania me numrin më të madh të vonesave është Albawings, për tu pasuar nga kompania Fly Ernest. Bie në syn një përmirësim i respektimit të orareve nga kompania "Blue Panorama", që regjistroi probleme të mëdha gjatë sezonit të verës dhe muajit shtator. Vetë kompanitë i arsyetojnë problemet e mos respektimit të orareve, kryesisht me probleme teknike.

Në tabelën në të djathtë paraqiten edhe numrat e saktë me vonesa dhe anulime të fluturimeve gjatë muajit Tetor 2018.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

KOMPANIA	SHTATOR	TETOR
ALBAWINGS	Vonesa mbi 2 orë	10
	Anullime	2
FLY ERNEST	Vonesa mbi 2 orë	5
	Anullime	1
BLUE PANORAMA	Vonesa mbi 2 orë	19
	Anullime	3
JETAIRFLY	Vonesa mbi 2 orë	2
	Anullime	
ADRIA	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anullime	
LUFTHANSA	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anullime	
BRITISH AIRWAYS	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anullime	
ALITALIA	Vonesa mbi 2 orë	
	Anullime	

Tabela përkatëse

REKORD KOMPENSIME


SHKON NË 442 NUMRI I KOMPENSIMEVE



Një element shumë i rëndësishëm që ka marrë edhe vemendjen maksimale të AAC është edhe respektimi i të drejtave të pasagjerëve, që lidhet me marrjen e kompensimit në rastet e vonesave apo anulimit të fluturimeve të palajmëruara më parë. Nga të dhënat zyrtare paraprahe që vijnë pranë Sektorit për të Drejtat e Pasagjerëve nga kompanitë ajrore, rezulton se janë gjithsej 442 kompensime në total me nga 250 euro, ose me bileta falas. Por numri pritet të rritet pasi një pjesë e madhe e formularëve të ankimit nuk kanë filluar ende vlerësimin.

Pavarësisht shifrave pozitive procesi po kalon një fazë ngadalësimi për shkak se një pjesë e madhe e pasagjerëve nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm të kompanitë ajrore, ndërsa në disa raste nuk kanë kthyer përgjigje në lidhje me atë që ju ka ofruar kompania.

AAC i bën thirrje gjithë personave që kanë plotësuar formularët e ankimit dhe ka kaluar afati prej 6 javësh, që të rikontaktojnë përsëri kompanitë ajrore që kanë patur fluturimin për tu njohur me statusin e fluturimit të tyre. Në rast se kompania nuk i kthen asnjë përgjigje, atëherë të kontaktojnë me sektorin e të Drejtave të Pasagjerit të AAC-së në numrat e telefonit: **+355 42 381 959 / +355 44 539 959** ose me email tek: **pax@acaa.gov.al** dhe do të marrin asistencën e nevojshme. Për më shumë informacion vizitoni gjithashtu dhe linkun e mëposhtëm:



www.aac.gov.al/te-drejtat-e-pasagjerit


ANALIZA STATISTIKORE PËR MUAJIN SHTATOR 2018

■ **SHTATOR 2018:** Referuar të dhënave zyrtare në Autoritetin e Aviacionit Civil, shifrat tregojnë një numër prej **299,354** pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Shtator për/ nga TIA, si dhe 46,375 pasagjerë kanë fluturuar me anë të linjave Charter. Bazuar në të dhënat, kompania ajrore “Blue Panorama” është mbizotëruese në treg duke mbuluar fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Shtator 2018, me një numër prej 55,817 pasagjerë ose 19% të totalit. Ndjekur nga fluturimet Charter, me 15% ndaj totalit dhe 46,375 pasagjerë dhe duke vijuar me kompanitë “Albawings” dhe “Ernest S.p.A” të cilat kanë secila 11% ndaj totalit.

NUMRI I PASAGJERËVE

Grafiku 1:


Grafiku paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve të muajit Shtator 2018 kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2016 dhe 2017



■ **PËRQINDJET:** Sipas të dhënave zyrtare, përqindjen më të madhe të tregut të transportit ajror për muajin Shtator 2018 vazhdon ta zotërojë Italia, duke zënë 49% të totalit, ndjekur nga fluturimet Charter me 15% si dhe nga Turqia, me 10%. Sikurse tregojnë edhe shifrat vëmë re se ka një tendencë në rritje nga viti në vit të numrit të pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet ajrit përgjatë muajit Shtator. Krahasimisht me vitin 2017, gjatë shtatorit të vitit 2018 një rritje prej 61% të fluksit të pasagjerëve kanë pasur fluturimet Charter. Ndërsa nga viti 2016 në vitin 2017 kanë shënuar një rritje prej 21%. Rritje në përqindje ka pasur gjithashtu edhe numri i pasagjerëve që kanë fluturuar me Charter ndaj totalit të pasagjerëve, rritje kjo sikurse duket edhe në grafikun si më poshtë, prej 15% ndërkohë që në 2017 dhe 2016 përqindja ka qenë 11%.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL




Grafiku 2:

Lëvizja e pasagjerëve e ndarë në % sipas operatorëve ajrorë, që kanë udhëtuar për/nga TIA gjatë muajit Shtator 2018.

AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUAJIT TETOR

BRUKSEL, AAC MERR PJESË NË SEMINARIN PËR PROGRAMIN E RI TË PUNËS

Në datën 25 Tetor 2018, Eurocontrol zhvilloi një workshop në lidhje me prezantimin e një programi kompjuterik pune (Toolsoftware) të ri shumë rolesh "Plan2Match", në aplikimin e skemës së performancës për shtete individuale dhe për hapësirat ajrore të shteteve (FAB), për përgatitjen e planeve të biznesit për NSA dhe ANSP. Në seminar merrnin pjesë 12 shtete sidomos nga vendet jo anëtare të BE-s, ku kërkesat për të aplikuar për skemën e performancës, do të bëhen të detyrueshme me anëtarësimin e këtyre shteteve. Shqipëria, si një shtet kandidat i BE-s, ka një detyrim për t'ju përmbajtur të gjitha rregulloret të vendosura nga Komisioni European, duke përfshirë ato që lidhen me "Qiellin e Vetëm Evropian" (SES). SES II ndryshoi fokusin e SES nga kapaciteti në performancë, ku një pjesë kyçe e kësaj ishte futja e një skeme të performancës që është e zbatueshme në të gjithë BE-në. Skema e Performancës synon të përmirësojë performancën e ANS-ve dhe funksioneve të rrjetit European



në Eurocontrol. Për këtë qëllim, ai përmban një sërë treguesish kryesorë të performancës (KPI), për të cilat shtetet duhet të vendosin objektiva, në fushat kryesore të performancës (KPA-s) të Efiçencës së Kostos, Kapacitetit, Sigurisë dhe Mjedisit, si dhe Treguesit e Performancës (PIs) për qëllime monitorimi. AAC duke i dhënë rëndësinë e duhur aktivitetit dërgoi një ekip pjesëmarrësish të kombinuar për të përfituar nga mundësitë e sistemit me përfaqësues nga:

- Sektori i Financës dhe Administratës
- Sektori i Planifikimit Strategjik
- ANS (lundrimi ajror)

Disa nga synimet e kësaj mbledhje, ishin:

1. Për përgatitjen e biznes planeve vjetore të AAC/NSA sipas rregullave të IAS (International Accounting Standard) dhe CRCO.
2. Planëzimin e objektivave strategjike të AAC/NSA në Planet vjetore dhe tre-pesë vjeçare.
3. Për vendosjen e PKI sipas skemës së performancës dhe rregulloren e re.

Sistemi është bazuar në një faqe interneti lehtësisht e aksesueshme nga përdoruesit.

Kjo platformë do të jetë për shtetet anëtare të Eurocontrol dhe Shqipëria do të bëhet pjesë e saj. Një plan në lidhje me zbatueshmërinë e programit "Plan2match" tregohet më poshtë:



TIRANË: "AAC-ICAO", ZHVILLOHET TRAJNIMI PËR INSPEKTORËT KOMBËTARË TË SIGURISË

Në kuadër të prioriteteve të vendosura për vitin 2018 AAC vijon të organizojë trajnime dhe workshope për rritjen e kapacitetit të stafit për të ushtruar funksionet e saj. Gjatë këtij muaj në datat 23-31 u zhvillua kursi i Sigurisë për inspektorët kombëtarë të Sigurisë, "ICAO AVSEC National Inspectors Course". Kursi u drejtua nga disa prej ekspertëve më të njohur në këtë fushë që vijnë nga shtete si Gjermania apo Sllovenia. Përveç stafit të AAC-s, ishin edhe përfaqësues nga agjencitë e tjera ligjzbatuese si policia por edhe përfaqësues nga autoritetet e tjera rajonale si Maqedonia. Ky kurs i dedikohet personelit për ti mundësuar inspektorëve të sigurisë njohuritë teorike dhe praktike rreth auditit dhe inspektimeve si pjesë e rëndësishme e programeve të sigurisë dhe kontrollit të cilësisë së sigurisë. Pjesëmarrësit në fund të këtij kursi do të jenë të aftë të përgatisin, koordinojnë dhe ndërmarrin



Në foto:
stafi i AAC gjatë trajnimit "ICAO AVSEC Inspector Course"


masat e kontrollit të cilësisë duke përdorur Aneksin 17 dhe metodologjinë e ICAO-s.

Aviacioni në Botë



STAMBOLL, TURQI: HAPET AEROPORTI MË I MADH NË BOTË

Është hapur zyrtarisht Aeroporti i ri i Stambollit që do të jetë edhe më i madhi në Botë me një ceremoni të veçantë inaugurimi ku morën pjesë politikanë nga e gjithë bota. Aeroporti i ri i Stambollit pritet të figurojë mes pesë aeroporteve më të frekuentuar në botë dhe mund të ngjitet në vend të parë të podiumit. "Për 10 vite, kapaciteti i pritjes së aeroportit pritet të arrijë deri në 200 milionë pasagjerë në vit", sipas operatorit IGA që do të shfrytëzojë aeroportin. "Në këtë rast ai do të jetë në rangun e parë të aeroporteve më të rëndësishëm në aspektin e kapacitetit të pritjes, sipas organizatës botërore të aeroporteve, "Airport Council International" (ACI). Në vitin 2017, ishte aeroporti amerikan i Atlantës që kishte dalë në krye të këtij klasifikimi me 103,9 milionë pasagjerë në vit. "Ai ndiqej nga Pekini (95,7 milionë), Dubai (88,2 milionë), Tokio (85,4 milionë) dhe Los Anxhelesit (84,5 milionë)", sipas ACI-së. Kur të jetë përfunduar plotësisht, ky aeroport do të jetë më i madhi në botë me 6 pista të pavarura, me një kapacitet prej 500 avionësh, me parkingje të hapura dhe të mbyllura për 70 mijë makina dhe me një kapacitet vjetor prej 200 milionë pasagjerësh. Për



Në foto:
pamje ajrore e aeroportit të ri të Stambollit - Shtator 2018

ndërtimin e aeroportit "Istanbul Jeni Havalimani" janë ndarë rreth 10,5 miliardë euro. Ndërtimi i aeroportit filloi në qershor të vitit 2014 dhe deri më tani ka përfunduar faza e parë prej katër fazave të ndërtimit.



Në foto:
pamje nga aeroporti i ri i Stambollit "Istanbul Havalimani"